



Fletëudhëzues: Të dhëna për përdoruesin

BRONCHOSTOP duo Hustenpastillen

Ekstrakt i thatë i bimës së trumzës, ekstrakt i thatë i rrënjëve të mëllagës së bardhë

Lexoni me kujdes të gjithë fletëudhëzuesin, përpara se të përdorni këtë bar. Përmban të dhëna të rëndësishme për ju.

Merrni gjithmonë këtë bar saktësisht siç përshkruhet në këtë fletëudhëzues ose sipas udhëzimeve të mjekut, farmacistit apo të profesionistëve shëndetësorë.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund t'ju duhet ta lexoni përsëri.
- Pyesni farmacistin tuaj ose profesionistë të kualifikuar shëndetësorë nëse keni nevojë për më shumë informacion ose këshilla.
- Nëse vini re efekte anësore flisni me mjekun ose farmacistin tuaj. Kjo përfshin efekte anësore të mundshme që nuk janë përmendur në këtë fletëudhëzues. Shihni seksionin 4.
- Flisni me mjekun tuaj nëse nuk ndiheni më mirë apo keni përkeqësim pas 5 ditësh.

Çfarë përmban ky fletëudhëzues:

1. Çfarë është *BRONCHOSTOP duo Hustenpastillen* dhe për çfarë përdoret
2. Çfarë duhet të dini përpara se të përdorni *BRONCHOSTOP duo Hustenpastillen*
3. Si të përdorni *BRONCHOSTOP duo Hustenpastillen*
4. Efekte të mundshme anësore
5. Si të ruani *BRONCHOSTOP duo Hustenpastillen*
6. Përbërësit e paketimit dhe të dhëna të tjera.

1. ÇFARË ËSHTË *BRONCHOSTOP DUO HUSTENPASTILLEN* DHE PËR ÇFARË PËRDORET

Bar bimor tradicional që përdoret për të lehtësuar acarimet e kollës dhe nxitur ekspektorimin e vazhdueshëm, të mukosit viskoz në kollën e shoqëruar me ftohje.

Ky produkt është një bar bimor tradicional për përdorim në indikacione të veçanta, bazuar vetëm në përdorime afatgjata.

Flisni me mjekun tuaj nëse nuk ndiheni më mirë apo keni përkeqësime pas 5 ditësh.

2. ÇFARË DUHET TË DINI PËRPARA SE TË PËRDORNI *BRONCHOSTOP DUO HUSTENPASTILLEN* ?

Mos përdorni *BRONCHOSTOP duo Hustenpastillen*

Nëse keni mbindjeshmëri ndaj bimës së trumzës, rrënjës së mëllagës së bardhë, anëtarëve të tjerë të familjes *Lamiacea* apo përbërësve të tjerë të këtij bari. (listuar në seksionin 6).

Paralajmërime dhe masa paraprake

Flisni me mjekun ose farmacistin tuaj përpara se të merrni *BRONCHOSTOP duo Hustenpastillen*. Në rast se keni gulçime, ethe apo sekrecione purulente, konsultohuni me mjekun tuaj.

Fëmijët

Tek fëmijët nën 4 vjeç kërkoni një këshillë mjekësore. Përdorimi tek fëmijët nën 4 vjeç nuk rekomandohet për shkak të mungesës së të dhënave.

Përdorimi tek fëmijët midis moshës 2 dhe 4 vjeç nuk rekomandohet për shkak të rrezikut të gëlltitjes pa dashje të gjithë tabletës.

Barnat e tjera dhe *BRONCHOSTOP DUO HUSTENPASTILLEN*

Flisni me mjekun ose farmacistin tuaj nëse jeni duke marrë, keni marrë kohët e fundit ose mund të merrni barna të tjera. Nuk njihen ndërveprime me barna të tjera.

Shtatzania, ushqyerja me gjë dhe fertiliteti

Nëse jeni shtatzënë ose ushqeni me gjë, mendoni se mund të jeni shtatzënë ose po planifikoni të keni fëmijë, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj përpara se të përdorni këtë bar.

Në mungesë së të dhënave të mjaftueshme, përdorimi gjatë shtatzënisë ose ushqyerjes me gjë nuk rekomandohet.

Drejtimi i automjeteve dhe përdorimi i makinerive

Asnjë studim nuk është kryer mbi efektet në aftësinë e drejtimit dhe përdorimin e makinerive.

BRONCHOSTOP duo Hustenpastillen përmban maltitol dhe sorbitol

Nëse mjeku ju ka thënë se keni intolerancë ndaj disa lloj sheqernash, flisni me mjekun tuaj përpara se të përdorni këtë bar.

Shënim për diabetikët

Një tablet korrespondon me afërsisht 0.1 njësi karbohidrate. Kjo duhet të merret parasysh në pacientët me diabet melitus.

3. SI TË PËRDORNI *BRONCHOSTOP DUO HUSTENPASTILLEN*

Gjithmonë merrni këtë bar sipas përshkrimit të saktë në këtë fletëudhëzues ose sipas këshillave të mjekut apo farmacistit.





Flisni me mjekun ose farmacistin tuaj nëse nuk jeni të sigurt.

Doza e rekomanduar është:

Të rriturit, të moshuarit dhe fëmijët mbi 12 vjeç:
2 tableta që treten në gojë çdo 3 deri 4 orë (4 deri 6 herë në ditë; Doza maksimale ditore është 12 tableta)

Përdorimi tek fëmijët

Fëmijët 4 deri 12 vjeç:
1 tabletë që tretet në gojë çdo 3 deri 4 ore (4 deri 6 herë në ditë; Doza maksimale ditore është 6 tableta)

Fëmijët nën moshën 4 vjeç:

Nuk rekomandohet përdorimi tek fëmijët nën moshën 4 vjeç. (Shikoni Seksionin 2).

Mënyra e administrimit:

Për përdorim oral (lejoni të tretet në gojë përmes përtypjes).

Kohëzgjatja e administrimit:

Flisni me mjekun nëse nuk ndiheni më mirë ose përkeqsoheni pas 5 ditësh

Nëse merrni më shumë BRONCHOSTOP duo

Hustenpastillen sesa duhet

Nëse merrni një mbidozë të konsiderueshme të këtij bari, efektet negative të njohura mund të ndodhin më shpesh. Në këtë rast, ju lutem njoftoni mjekun tuaj. Ai/ajo mund të vendos për masat e nevojshme.

Nëse harroni të merrni BRONCHOSTOP duo

Hustenpastillen

Mos merrni një dozë të dytë për të kompensuar një dozë të harruar.

Nëse keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun apo farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Ashtu si të gjitha barnat, *BRONCHOSTOP duo Hustenpastillen* mund të shkaktojë efekte negative, megjithëse jo të gjithë mund të preken nga ato.

Reaksionet e mbindjeshmërisë dhe shqetësimet gastrointestinale janë studiuar në lidhje me barnat që përmbajnë trumzë. Frekuenca e shpeshtësisë nuk dihet.

Raportimi i efekteve anësore

Nëse vini re ndonjë efekt anësor, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj. Kjo përfshin çdo efekt negativ jo të listuar në këtë fletëudhëzues. Ju gjithashtu mund të raportoni efekte anësore direkt përmes sistemit kombëtar të raportimit:

Austrian Federal Office for Safety in Health Care
Traisengasse 5
1200 Vienna
Austria
Fax: + 43 (0) 50 555 36207
Website: <http://www.basg.gv.at/>

Përmes raportimit të efekteve anësore, ju mund të ndihmoni për të siguruar më shumë informacion mbi sigurinë e këtij bari.

5. SI TË RUANI BRONCHOSTOP DUO HUSTENPASTILLEN

Mos e ruani mbi temperaturën 30°C.
Mbajeni këtë bar larg shikimit apo arritjes së fëmijëve.

Mos e përdorini këtë bar pas datës së skadencës të shënuar në paketimin e brendshëm dhe të jashtëm pas "Use by".
Data e skadencës i referohet ditës së fundit të atij muaji.

Mos hidhni asnjë bar me anë të rrugëve të ujërave të zeza apo mbeturinave shtëpiake. Pyesni farmacistin tuaj se si duhet t'i hidhni barnat që nuk përdorni më. Këto masa do të ndihmojnë për të mbrojtur mjedisin.

6. PËRBËRSIT E PAKETIMIT DHE INFORMACIONE TË TJERA

Çfarë përmban BRONCHOSTOP duo Hustenpastillen

Një tabletë që tretet në gojë përmban:

Lëndët aktive janë:

Ekstrat i thatë i bimës së trumzës, ekstrakt i rrënjës së mëllagës së bardhë

51.1 mg ekstrat i thatë i bimës së trumzës (bima e trumzës, shkalla e ekstraktimit të barit = 7-13 : 1; agjent ekstraktimi :ujë) dhe

4.5 mg ekstrakt i rrënjës së mëllagës së bardhë (rrënjë, shkalla e ekstraktimit të barit = 7-9 : 1; agjent ekstraktimi :ujë)

Eksipientët janë:

Akacie (gomë arabike, sorbitol i lëngshëm (E 420), maltitol i lëngshëm (E 965), maltodekstrin, acid citrik, anhidrat, sakarozë natriumi, aromë aronie, aromë fruta pylli, vaj parafine, dyll i bardhë blete, ujë i purifikuar.

Çfarë pamje ka BRONCHOSTOP duo

Hustenpastillen dhe përbërsit e paketimit

BRONCHOSTOP duo Hustenpastillen janë tableta kafe të rumbullakëta të paketuara në blistera alumini PVC/PE/PVdC, të cilat përmbajnë 10, 20, 30 ose 40 tableta që treten në gojë. Jo të gjitha paketimet mund të tregohen.

Mbajtësi i Autorizimit të Tregimit Prodhuesi

Kwizda Pharma GmbH, Effingergasse 21, 1160 Wien, Austria

Prodhuesi

Kwizda Pharma GmbH,
Effingergasse 21, 1160 Wien,
Austria

Bolder Arzneimittel GmbH & Co. KG,
Rheinische Allee 11,
50858 Cologne
Germany

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Qershor 2016.

